



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 261 Prot.

Tiranë, më datë 25.04.2025

VENDIM

Nr. 235, datë 25.04.2025

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Sqj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 25.04.2025:

VENDOSI

1. Shtyrjen e Vendimmarrjes për projektin “Hartimi i Planeve të Konservimit dhe Gërmimeve Arkeologjike të Amfiteatrit Romak, Forumit Bizantin dhe Banjave Romake dhe të Shtigjeve Urbane në Zonat Arkeologjike A dhe B të Qytetit të Durrësit”, Monument Kulture i Kategorisë së I-rë, me aplikues Taulant sh.p.k. dhe zhvillues **Ministria e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit me rekomandimin;**
 - Ndërhyrjet konservuese dhe restauruese në mozaikët e kapelës të kryhet ‘in-situ’ dhe të mos kryhet shkëputje e tyre nga suporti origjinal;
 - Të rishikohet preventivi lidhur me ndërhyrjet në mozaikë, sipas diskutimit në KKTKM;
 2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
 3. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Joli MITROJORGJI

